



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Nr. 644/2 Prot

Tiranë, më 02/03/2021

Lënda: Njoftim për shpallje të lëvizjes paralele

SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE _____

DREJTORISË RAJONALE TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK _____

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Urdhërit nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” dhe shkresës nr.639 prot, datë 25.02.2021 “Njoftim për për vende të lira pune (mundësi për lëvizje paralele)” të Shkollës së Mesme Profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë, protokolluar në AKPA me nr.644 prot, datë 26.02.2021,

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ju njofton shpalljen e procedurave të lëvizjes paralele për personelin mësimdhënës të formimit praktik, në Shkollës së Mesme Profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë, për pozicionin:

- Mësimdhënës i formimit praktik me kohë të plotë në drejtimin TIK – 1 (një) mësues

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të formimit praktik në Shkollës së Mesme Profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë

Aplikanti për mësimdhënës të kulturës profesionale në Shkollës së Mesme Profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;

- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të formimit praktik si vijon:

- a) të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose të nivelit *bachelor* në një nga profilet, që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

2. Vendi dhe afati i dorëzimit të dokumentave

Aplikantët duhet të dorëzojnë kërkesën për lëvizje paralele dokumentat të cilat duhet të jenë origjinal ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara. Dokumentacioni përkatës duhet dorëzuar pranë Shkollës së Mesme Profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë. Afati i njoftimit fillon më datë 05.03.2021.

Nëse nuk paraqiten kërkesa për lëvizje paralele, në zbatim të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, brenda afatit të mësipërm, Shkollës së Mesme Profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë të fillojë procedurën për shpalljen e vendit të lirë, për pozicionin:

- Mësimdhënës i formimit praktik me kohë të plotë në drejtimin TIK – 1 (një) mësues

Shkolla së Mesme Profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë brenda 5 ditëve pune pasi është mbyllur procedura e lëvizjes paralele dhe nuk është paraqitur asnjë kërkesë për lëvizje paralele, shpall njoftimin për vendin e lirë në faqen zyrtare të AKPA-s, në faqen elektronike zyrtare të Shkollës së Mesme Profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të Shkollës së Mesme Profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Elira DEMIRAJ

